

RAPORT
MONITORIMI

**TRANSPARENCA
DHE MENAXHIMI
FINANCIAR NË
REZIDENCËN
STUDENTORE
UNIVERSITARE
NR.1**

TIRANË, 2020



PËRMBAJTJA

1. HYRJE
2. GJETJET KRYESORE
3. ANALIZA E GJETJEVE TË MONITORIMIT
 - 3.1 SHËRBIMET E OFRUARA NGA RSU NR. 1 NDAJ STUDENTËVE
 - 3.1.1 KONTRATAT E AKOMODIMIT
 - 3.1.2 SHËRBIMI NË RAPORT ME TARIFËN E AKOMODIMIT
 - 3.1.3 KRAHËSIMI ME QENDRËN E STUDENTËVE, PRISHTINË
 - 3.2 KONTRATAT DHE PROKURIMET 2019
 - 3.2.1 INVESTIMET NË GODINA
 - 3.2.2 TËRMETI, MASAT DHE PASOJAT NË RSU NR. 1
 - 3.2.3 NDËRTIMI I KAMPUSIT TË RI UNIVERSITAR.ME PPP DHE PA KONSULTIM PUBLIK.
4. ZBATIMI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT NGA DREJTORIA E RSU NR. 1
5. KONTRATAT E SPONSORIZIMIT NGA RSU NR. 1 PËR VITIN 2019
6. REKOMANDIME



Ky botim u realizua nga Qëndresa Qytetare në kuadër të projekti Këshilli i Qytetit Studenti, me mbështetjen financiare të USAID. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

1. HYRJE

ZHVILLIMI I QYTETIT STUDENTI



Me hapjen e Universitetit Shtetëror të Tiranës, i cili u inagurua me 16 Shtator të 1957-ës, u krijuan premiset e një qyteti studentor në Tiranë, rreth viteve 1967-70 në "Qytetin Studenti" kishte pak godina, një mensë, një qendër shëndetësore, që siguronin shërbimet parësore dhe më të domosdoshme për studentët, në këtë periudhë filluan përpjekjet e para për ndërtimin e një biblioteke për studentët që banonin aty. Gjithashtu filluan të bëhen investime të konsiderueshme duke ndërtuar dhe godina të reja, u pastrua dhe u gjelbërua terreni rreth godinave, elektrifikimi i godinave, duke i dhënë një pamje tërheqëse qytetit, i cili akomodonte ato vite rreth 3000 studentët konviktorë.

Në vitin 1978 bëhet inagurimi i Kino-klubit "Studenti" që do të bëhej qendra e aktiviteteve të këtij institucioni. Aty kishte sallë kinemaje, konferencash dhe sallë lojërash.

Me rritjen e numrit të studentëve, rreth 6000 në vitet 80-90, lindi nevoja e shtimit të godinave që u ndërtuan nga puna vullnetare.

Qyteti Studenti sot është një lagje në Njësinë Administrative "Tirana 2" në Bashkinë e Tiranës dhe mban emrin **Rezidenca Studentore Universitare Nr.1**, e cila është struktura më e madhe akomoduese e studentëve në vendin tonë. Numri maksimal i akomodimit ndër vite ka qënë 5400 studentë dhe sot mendohet të ketë një numër prej 5000 studentësh banor në të.

Në këtë sit urban është shkruar një nga faqet më të rëndësishme të historisë moderne shqiptare, e cila është 'gatuar' në mjediset e tij sot të degraduara dhe 'të pushtuara' nga informaliteti.



“Qytetit Studenti” shtrihet në një sipërfaqe rreth **25 hektarësh**, nga të cilat 6.7 hektar janë të zëna nga ndërtime informale.

Përgjatë 30 viteve tranzicion arsimit në vend ka qenë një e drejtë për të gjithë, e cila shtoi numrin e shqiptarëve të cilët do të ndiqnin universitetin, element ky i cili nuk u ndoq nga rritja e investimeve për të akomoduar ata.

Qyteti Studenti sot akomodon rreth 5000 studentë dhe përballet me sfidat emergjente të:

- a) Përmirësimit të kushteve të objekteve ekzistuese.
- b) Shtimit të ndërtimeve të reja (prej 90-tës numri i studenteve është shumëfishuar ndërsa kapacitet pritese prej atëhere janë ulur).
- c) Përmirësimit të kushteve të jetës social-kulturore.
- d) Përmirësimit të hapësirave kolektive e publike të kampusit.
- e) Përcaktimit të kufijve të qartë të tij dhe ndarjen përfundimisht të kampusit nga zona e ndërtimeve informale.

Në vitin 2015 Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, realizoi konkursin ndërkombëtar për hartimin e Mastër-Planit dhe rehabilitimin e “Rezidencës Studentore Universitare Nr. 1”, fitues të së cilës ishin studio Baukuh¹ + LIST. Projekt i cili u la në heshtje dhe pas 4 vitesh riaktivizohet dhe sillet sërisht për publikun në muajin Janar 2019 si rezultat i presionit të protestës së studentëve, me premtimin se do të realizohet brenda mandatit të 2-të Kryetarit të Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj.



¹<https://www.baukuh.it/works/student-city-campus/>

QËNDRESA QYTETARE DHE USAID

Nisur nga vëmendja e lartë e treguar nga ana e qeverisë dhe medias ndaj kushteve dhe gjendjes së godinave në konvikte dhe mungesa e transparencës së këtyre investimeve, Qëndresa Qytetare me mbështetjen e USAID realizoi këtë monitorim, i cili ka të bëjë kryesisht me **nxitjen e transparencës dhe menaxhimin financiar efektiv në Rezidencën Studentore Universitare Nr. 1**, Tiranë, gjatë periudhës 1 Janar – 31 Dhjetor 2019.

Në këtë monitorim do të përfshihet edhe **Këshilli i Qytetit Studenti**, strukturë informale e pavaruar e ndërtuar dhe fuqizuar nga Qëndresa Qytetare e përbërë nga 23 studentë, banorë në godinat e RSU Nr.1 dhe përfitues direkt të investimeve dhe shërbimeve që ofron kjo shoqëri akomodimi.

QËLLIMI

Qëllimi kryesor i këtij monitorimi është zbardhja dhe publikimi i të dhënave, kontratave dhe gjendjes së godinave pas investimeve dhe restaurimeve të kryera gjatë vitit 2019 në Rezidencën Studentore Universitare Nr. 1. Informimi i publikut, taksapaguesve dhe studentëve që paguajnë tarifën dhe banojnë në këto godina është në funksion të nxitjes së llogaridhënies dhe përmirësimit të qeverisjes.

INVESTIME TE REJA NE QYTETIN STUDENT

300 MILION LEKË TË REJA NGA BUXHETI I SHTETIT

Para protestës studentore të Dhjetorit 2018, gjendja e infrastrukturës në konvikte paraqitej tejte e amortizuar pothuajse në të gjitha ndërtesat në Tiranë edhe në rrethe. Ndërtesat kishin nevojë urgjente për rehabilitim, pajisje me mobilie, shtretër, bazë materiale, dyshekë e çarçafë të rinj. Qeveria shqiptare nën presionin e protestës studentore adresoi këtë problematikë duke akorduar një grant shtesë në masën 300 milion lekë të reja nga buxheti i shtetit për investimet në konvikte. ²


²<https://www.oranews.tv/article/qeveria-ndan-grantin-prej-300-mln-lekesh-konviktet>

3 MILION EURO KFW (BANKA GJERMANE PËR ZHVILLIM)

Njëkohësisht qeveria shqiptare në mujin Mars 2019, aktivizoi menjëherë marrëveshjen e grantit me KFW (Banka Gjermane për Zhvillim) në vlerën 3 milion euro me qëllim investimin e këtij fondi në RSU Nr.1. Sipas kësaj marrëveshje, programi synonte rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës, në funksion të rritjes së efikasitetit të energjisë dhe të kushteve të përshtatshme të studentëve, sipas kërkesave minimale të performancës së energjisë. Në varësi të buxhetit në dispozicion, projekti do të përfshijë rehabilitimin e godinave nr. 3, 14, 16, 17 dhe 18 edhe nëse do të jetë e mundur dy(2) deri në katër(4) godina të tjera konviktesh.³

TEANSPARENCA

Referuar raportit të Paktit për Universitetin të publikuar nga Qëndresa Qytetare, i gjithë procesi i investimeve në konvikte është shoqëruar nga mungesa e transparencës financiare, në asnjë publikim zyrtar dhe program transparence të institucioneve përgjegjëse nuk ka të dhëna financiare mbi përdorimin e fondeve publike si relacione kontratash apo detaj të proceseve. Daljet publike të zyrtareve nuk kanë dhënë asnjë informacion mbi transparencën financiare edhe pse titullarët kryesorë të Pushtetit Qëndror dhe Vendor kanë realizuar dalje të përmuajshme mediatike në këto godina.⁴



³<https://www.infrastruktura.gov.al/nenshkruhen%203%20marreveshje%20bashkepunimi%20mes%20qeverise%20shqiptare%20qeverise%20se%20republikes%20federale%20te%20gjermanise%20dhe%20qeverise%20franceze/>

⁴<http://qq.com.al/ep-content/uploads/2020/01/6.3.pdf>

GJETJET KRYESORE

- **Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 nuk ofron shërbimin e mensës dhe ngrohjes qëndrore për studentët shërbime keto të parashikuara në statutin dhe ekstraktin e kesaj rezidence.** 80.3% e studentëve shprehen se, Qyteti Studenti duhet të ofrojë vetë shërbimin e mensës ndërsa 50.8% e tyre i konsiderojnë çmimet në mensat private si të papërballueshme.
- **Kontratat e akomodimit në Qytetin Studenti kanë probleme ligjore të formulimit të një kontrate me të drejta dhe detyrime 2-palëshe.** Kontrata shfaqet në disa variante me çmime të ndryshme në varësi të kushteve të godinave duke diskriminuar studentët bazuar në mundësitë e tyre financiare.
- **Të ardhurat e RSU NR. 1 për vitin 2019 ishin 8.859.000 euro, ndërsa blerjet dhe investimet nëpërmjet prokurimeve publike 2.285.600 euro.** 57.5% e studentëve shprehen se këto investime kanë qënë thjesht ndërhyrje vetëm në fasadë, 25.4% mendojnë se investimet nuk kanë sjellë përmirësime infrastrukturore dhe 16.6% e tyre shprehen se ato kanë përmirësuar disi kushtet brenda godinave.
- Tre ditë pas tërmetit të 26 Nëntorit 2019, Bashkia Tiranë vendosi të shembë tre(3) godinat e banuara nga qytetarë dhe të rikonstruktojë katër(4) godinat e banuara nga studentët në Qytetin Studenti. **Vlerësimi i dëmeve të tërmetit në katër(4) godinat u krye nëpërmjet një procedure me negociim pa shpallje paraprake në vlerën 112 000 euro,** duke shmangur asistencën e ekspertëve të ndërtimit vullnetarë të jashtëm dhe vendas.
- Bashkia Tiranë do të ndërtojë **Kampusin e Ri Universitar nëpërmjet Partneritetit Publik-Privat (PPP).**⁵ **Procesi i përzgjedhjes së projektit, kompanisë dhe përfitimit të saj është jo transparent dhe në komisionin përzgjedhës nuk përfshiu as studentët** që do e përdorin dhe as RSU NR.1 që do e administrojë atë.
- Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 rezulton si një **nga Autoritetet Publike me nivel shumë të ulët transparence dhe llogaridhënie.** RSU Nr.1 refuzoi 3 herë kërkesën për informacion të Qëndresës Qytetare, pasi nuk kishte emëruar Koordinator për të Drejtën e Informimit. Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 nuk disponon një faqe interneti funksionale për të publikuar procedurat dhe kriteret e akomodimit në rezidencë, kontratat, shpenzimet dhe gjithçka që lidhet me llogaridhënien publike
- Si rezultat i keqmenaxhimit gjatë tranzicionit, Qyteti Studenti **ka humbur funksionin që mbante në vitet 70' – 90' si Kampus Universitar** duke humbur shërbimet, territorin dhe godinat.

2. ANALIZA E GJETJEVE TË MONITORIMIT

3.1 SHËRBIMET E OFRUARA NGA RSU NR.1 NDAJ STUDENTËVE


Bazuar në statutin e shoqërisë RSU Nr.1, objekt te veprimatrise se saj është:

Trajtimi në fjetore dhe mensa i studentëve të Universitetit Tiranë. Prodhim dhe furnizim me avull për ngrohje të të gjitha ambienteve të ndërmarrjes dhe për të tretë. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe largimi i ujërave të përdorura të Qytetit Studenti. Pastrim, gjelbërim dhe mirëmbajtja e rrugëve të brëndshme të Qytetit Studenti. Krijimi i kushteve për veprimtari kulturore e sportive, salla leximi e dëfrimi dhe ambiente çlodhëse. Shërbim bibliotekar dhe social për studentët. Veprimtari të tjera shërbimi nëpërmjet dhënies me qira të ambienteve subjekteve të ndryshme për shërbime private.


- **Trajtimi me fjetore dhe menca i studentëve**

Trajtimi me fjetore është shërbimi kryesor të cilin kjo rezidencë e ofron, por pavarësisht se sipas ekstraktit dhe statudit të shoqërisë, RSU Nr.1 duhet të ofrojë edhe **shërbimin e mencës**, ky **i fundit nuk ofrohet** nga administrata e RSU Nr.1. *Ndërkohë 80.3% e studentëve të pyetur shprehën se Qyteti Studenti duhet të ofrojë vetë shërbimin e mencës ndërsa 50.8% e studentëve i konsiderojnë çmimet në mensat private si të papërbalueshme për ekonominë e tyre personale dhe 49.2% e tyre i konsiderojnë ato të përballueshme.*

A mendoni se Q.S duhet të ofrojë shërbimin e ushqimit me mensa shtetërore?




Si i konsideroni çmimet në mensat private & FastFood-et përreth Q.S?



- ***Prodhimi dhe furnizimi me avull për ngrohje të të gjitha ambienteve në zotërim të RSU Nr. 1***

RSU Nr.1 **nuk ofron furnizim për ngrohje qendrore të godinave** në Qytetin Studenti. Këtë e dëshmojnë vetë studentët të cilët, në kundërshtim edhe me dispozitat e kontratës së akomodimit sjellin ngrohëse në mënyrë private në dhomat e tyre.

Sipas pyetësorit të realizuar në muajin Shkurt 2020 nga Qëndresa Qytetare, 97.5% e studentëve u shprehën se ngrohjen në dhomën e tyre e sigurojnë nëpërmjet pajisjeve të sjella privatisht në konvikt, ndërsa vetëm 2.6% e tyre u shprehën se ngrohja sigurohet nëpërmjet sistemit të konvikteve.



97.5% Nëpërmjet pajisjeve të sjella privatisht

2.6% Nëpërmjet sistemit të ngrohjes së konvikteve

- ***Shërbimi bibliotekar dhe social për studentët***

Dy objekte të rëndësishme të cilat ofronin shërbime social-kulturore dhe utilitare si **Kino-Klubi "Studenti"** sot dhe Godina "Iliria" edhe **ish-Menca e Qytetit Studentit**, kanë humbur funksionalitetin dhe i'u është tjetërsuar destinacioni i tyre përgjatë 30 viteve tranzicion, *"dhënia me qira e godinave dhe ambienteve pranë tyre është forma më masive e abuzimit"* sipas raporteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit 2013.


Kino-Klubi "Studenti"



Ish-Menca e Qytet Studentit



65.3% e studentëve i vlerësojnë si të papërshtatshme kushtet dhe sallat e bibliotekës dhe vetëm 34.7% janë të kënaqur ose disi të kënaqur me këto ambiente studimi. Kjo situatë është krijuar edhe për shkak se biblioteka është shndërruar në ambient gjumi për studentët e 4 godinave që janë në restaurim.




Shërbime të tjera të cilat janë të parashikuara në statutin dhe ekstraktin e shoqërisë janë:

- Furnizimi me ujë të pijshëm dhe largimi i ujrave të përdorura nga Q.S
- Pastrimi, gjelbërimi dhe mirëmbajtja e rrugëve të brendshme të Q.S
- Krijimi i kushteve për veprimtari kulturore, sportive, salla leximi, dëfrimi dhe ambiente çlodhëse.

Interneti “Free Ëi-Fi”

Më 18 Janar 2019 Bashkia Tiranë startoi nismën “Tirana Smart City” për ofrimin e internetit falas në kampusin e “Qytetit Studenti”⁶ ku të gjithë dhomat e studentëve në të gjitha godinat do të ishin të pajisura me internet falas.

Ndërkohë që në Shkurt të vitit 2020, nga 200 studentë të pyetur nëse kanë akses në internet falas në dhomën e tyre vetëm 8.3% e tyre kanë pohuar këtë fakt, 91.7% duhet t’i drejtohen sheshit kryesor apo bareve për të aksesuar internetin.



Pas suksesit të ofrimit të shërbimit “Free Wi-Fi” në sheshin “Skënderbej”, Bashkia e Tiranës ka startuar nismën “Tirana Smart City” për ofrimin e internetit falas edhe në kampusin e “Qytetit Studenti”. Të gjithë dhomat e studentëve në të gjitha godinat e këtij kampusi do të jenë të pajisura me internet, ndërkohë që akses do të ofrojnë edhe sallat e leximit. Për të lehtësuar jetën e studentëve në këtë kampus, Bashkia e Tiranës ka vendosur që shërbimin e internetit flas ta ofrojë edhe në të gjithë ambientet publike. Kjo nismë e Bashkisë Tiranë dhe e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit krijon më shumë mundësi studentët, banorë të kësaj rezidnece, për kushte më të lehta studimi duke shfrytëzuar aksesin në internet dhe mundësitë që ai ofron. Nisma të këtij lloji do të vijojn edhe në vazhdim, duke u përpjekur të sjellim për qytetarët e Tiranës shërbime gjithnjë e më inovative. Në ambientet e Qytetit Studenti, ky shërbim u mundësua nga kompania Tring.




⁶<https://www.tirana.al/pika-interesi/qyteti-studenti>

3.1.1 Kontrata e akomodimit

Rezidenca Studentore Nr.1 ka lidhur **“Kontrata Akomodimi”** me studentët bazuar në nenet 801, 802 të Kodit Civil, nene të cilat i përkasin kreut të “qerasë”, ndërkohë që në rastin e RSU Nr.1 kemi të bëjmë me shërbim hotelerie ku baza ligjore mbështetet në ligjin për turizmin.⁷ Së dyti, përmbajtja e kontratës së akomodimit shfaqet në disa versione, të cilat parashikojnë çmime dhe obligime të ndryshme në varësi të godinave. Ky trajtim me standarte të ndryshme në varësi të gjendjes së godinave përbën shkak për sjellje diskriminuuese ndaj studentëve. Rritja e çmimit vihet re tek godinat nr.1 dhe nr.13 të cilat kanë ndryshim nga të tjerat vetëm brenda dhomës, e cila jo vetëm ka sjellë një ndryshim në çmim, por ka bërë që edhe terminologjia me të cilën banorët e Qytetit Studenti i drejtohen këtyre godinave me kushte nomrale dhe çmim më të lartë është si të mos ishin publike duke i titulluar “Konvikte Private”.

Problem tjetër në aspektin e përmbajtjes së kontratave të akomodimit janë edhe nenet që i referohen të **drejtave dhe detyrimeve të studentëve**, ku **e vetmja e drejtë** e parashikuar në “Kontratën e Akomodimit” është **detyrimi** për të zbatuar rregulloren. Kontratat janë

mërrëdhënie dypalëshe, ku kryesisht pala që paguan para duhet të ketë më shumë të drejta për të përdorur ambientin dhe për të marrë shërbime.




Në mungesë të informacionit dhe të edukimit juridik qytetar, studentët plotësojnë dosjen dhe kryejnë pagesën e tarifave pranë Rezidencës pa marrë mbrapsht kontratën apo pa e nënshkruar atë. Studentët të cilët e kërkojnë kopjen e kontratës u jepet e plotësuar me të dhënat e nevojshme por e pa firmosur nga palët, e cila e bën të vlefshëm këtë dokument, si në rastin e paraqitur të një kontrate të lidhur përgjatë 2019 me një nga studentët banor i Q.S. Kjo sjellje nuk përsëritet me dokumentin e marrjes në dorëzim të dhomës dhe asetëve brenda saj, ku studentët dhe kujdestarët e godinave firmosin dokumentat paraprake.

⁷http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/Ligi_93-2015.pdf

3.1.2 Shërbimi në raport me tarifën e akomodimit

RSU Nr.1 aplikon tarifa të ndryshme për studentët, në varësi të godinave dhe kjo vihet re nga llojet e kontratave të akomodimit në të cilat ndryshojnë tarifat. Shumica e studentëve paguajnë 45.000 lekë të reja për nëntë(9) muaj akomodim në Rezidencën Studentore.

Studentët u pyetën për të shprehur opinionin e tyre nëse ishin të kënaqur për shërbimin që merrnin në raport me tarifën që paguanin. 54.4% e studentëve janë të pakënaqur dhe mendojnë se meritojnë shërbim më dinjitoz për tarfiën që paguajnë, 4.5% e tyre janë disi të kënaqur dhe vetëm 4.2% e tyre janë shumë të kënaqur me shërbimin që u ofrohet.



3.1.3 Krahësimi me Qendrën e Studentëve, Prishtinë



Për një këndvështrim objektiv dhe krahesimor kemi studiuar shembullin e Qendrës së Studentëve, të Universitetit të Prishtinës, e cila është një shoqëri që akomodon mesatarisht 3600 studentë çdo vit akademik. Diferencat janë të mëdha dhe nisin nga procesi i përzgjedhjes së studentëve deri tek shërbimet e ofruara dhe tarifat e aplikuara. Në Qendrën e Studentëve, Prishtinë procesi i përgjedhjes së studentëve kalon në filtra dhe kritere që lidhen me vendndodhjen, kushtet ekonomike dhe mesataren në mësim të studentëve aplikantë, ndryshe nga procesi që ndjek RSU Nr.1, komplet jo transparent dhe shpesh here i ekspozuar ndaj korrupsionit.














KOSOVË		KONVIKTET		SHQIPËRI
20 €/muaji	<input checked="" type="checkbox"/>	 Tarifa e akomodimit		37 €/muaji
15 €/muaji 2 vakte në ditë	<input checked="" type="checkbox"/>	 Ushqimi, TV & Wi-fi	<input checked="" type="checkbox"/>	Nuk ofrohet
Përfshihet në tarifë	<input checked="" type="checkbox"/>	 Lavanderi		1.2 €/larja
Ofrohen	<input checked="" type="checkbox"/>	 Terrene sportive	<input checked="" type="checkbox"/>	Nuk ofrohen
 Përzgjedhja e studentëve				
Po	<input checked="" type="checkbox"/>	Kritere dhe pikëzim	<input checked="" type="checkbox"/>	Jo
Kryhet Online	<input checked="" type="checkbox"/>	Regjistrimi		 Kryhet Fizikisht
Në Bordin përzgjedhës përfshihet 1 student.	<input checked="" type="checkbox"/>	 Pranimi		 Regjistrimi kryhet nga kujdestarët, pa konkurs

Tabela krahasimore mes dy shoqërive të akomodimit për të evidentuar diferencat.

2.2 KONTRATAT DHE PROKURIMET 2019

Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 operon si Shoqëri Aksionere me pronare Bashkinë Tiranë dhe kapital themeltar 17.6 milionë euro.⁸ Objekti i veprimtarisë së RSU NR.1 është *“Trajtimi në fjetore dhe mensa i studentëve të Universitetit Tiranë. Prodhim dhe furnizim me avull për ngrohje të të gjitha ambienteve të ndërmarrjes dhe për të tretë. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe largimi i ujërave të përdorura të Qytetit Studenti. Pastrim, gjelbërim dhe mirëmbajtja e rrugëve të brendshme të Qytetit Studenti. Krijimi i kushteve për veprimtari kulturore e sportive, salla leximi e dëfrimi dhe ambiente çlodhëse. Shërbim bibliotekar dhe social për studentët. Veprimtari të tjera shërbimi nëpërmjet dhënies me qira të ambienteve, subjekteve të ndryshme për shërbime private.”*

Administratore e shoqërisë është znj. Anila Shehu, ndërsa Anëtarët e Bordit janë tre zyrtarë të lartë të Bashkisë dhe qeverisë:

- **Plarent Ndreca** – Anëtar i Këshillit Bashkiak Tiranë dhe Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme.
- **Anuela Ristani** – Nënkryetare e Bashkisë Tiranë
- **Ditjon Baboçi** – Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Urban në Bashkinë Tiranë

Qëndresa Qytetare vendosi të monitorojë dhe bëjë transparencën financiare të kësaj shoqërie duke marrë parasysh që vëmendja e qeverisë, medias dhe ndërkombëtarëve, për shkak edhe të protestës studentore u drejtua edhe tek situata e rezidencave studentore. Nisur nga kushtet e papërshtatshme të jetesës të evidentuara në fillim të vitit 2019 edhe nga vetë qeveria shqiptare u akorduan fonde nga disa burime duke rritur kështu buxhetin në dispozicion të RSU Nr. 1 për të përmirësuar kushtet dhe shërbimet ndaj studentëve në godina.

Në tabelën e mëposhtme ekspertët e Qëndresës Qytetare kanë renditur të ardhurat zyrtare në drejtim të RSU Nr. 1 gjatë vitit 2019 si edhe burimet e tyre. Sipas të dhënave zyrtare të qeverisë dhe burimeve ligjore të të dhënave të përdorur nga Qëndresa Qytetare, shuma e vënë në dispozicion të RSU Nr. 1 gjatë vitit 2019, rezulton **8.859.000 euro**.

⁸http://www.opencorporates.al/sg/nipt/k51814005n?fbclid=IwAR2PJgdEYLBHLZ16jKf8clBy_xunOhF8-ua54QcBdt24AKqx7bl1tkYoTLo#collapsebordMember3627List

3.2.1 Investimet në godina

Gjatë vitit 2019 RSU Nr.1 ka realizuar disa ndërhyrje në godinat e Qytetit Studenti për të cilat ka zhvilluar procedura tenderimi sipas ligjit për Prokurimet Publike. Më poshtë po rendisim disa nga procedurat e prokrimeve që ka kryer RSU Nr.1 të cilat mund të konsiderohen edhe si shpenzimet kryesore të realizuara gjatë vitit 2019 me burimet e të ardhurave të përmendura më sipër.

Te ardhura (Shuma)	Burimi
2.500.000 euro	Ndihmë ekonomike shtetërore nga qeveria 13 Shtator 2019
3.000.000 euro	Fondi i KFW në dispozicion të RSU Nr. 1
1.240.000 euro	Grante periodike mujore nga MASR
60 000 euro	Te ardhura nga kontrata me Tirana Parking 5000 euro/ muaji
2. 000. 000 euro	Të ardhura nga tarifat e studentëve
30.000 euro	Të ardhura nga objektet me qera
29.000 euro	Të ardhura nga akomodime të tjera
8.859.000 Euro	Totali

OBJEKTI I KONTRATËS	SHUMA NË EURO	DATA (2019)
Rikonstruksion i godinave 11 dhe 12.	2.000.000	21/10
Supervizim i rikonstruksionit të godinave 11 dhe 12	22.300	02/09
Riparimi i pjesshëm i dhomave në godinat (5,20,21,26,27,28,29)	165.000	27/5
Blerje detergjente dhe material pastrimi	9.000	14/01
Blerje materiale ndërtimi dhe marangozërie	35.500	10/06
Blerje material elektrike dhe hidraulike	45.000	10/06
Blerje karburant për mjetet	8.800	30/09
TOTALI I PROKURIMEVE PËR VITIN 2019	2.285.600	euro pa tvsh

Buletini Nr. 36 datë 09 Shtator 2019

Agjencia e Prokurimit Publik

REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR 1

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor
 Emri Rezidenca Studentore Universitare Nr 1
 Adresa Qyteti Studenti Tirane
 Tel/Fax +355 4 2376214
 E-mail rezidencastudentore@gmail.com
 Faqja e Internetit www.qytetistudenti.gov.al
2. Lloji i procedurës: Procedure e hapur
3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër "Shërbimi, riparimi i pjesshëm i dhomave Godina Nr. 5, Godina 20-21, Nr,26-27 dhe Nr. 28-29".
4. Numri i referencës së procedurës/lotit REF-23147-05-22-2019
5. Fondi limit 20 040 052 (njëzet milion e dyzet mijë e e pesëdhjetë e dy) lekë pa tvsh.
6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opcionet dhe nenkontraktimin):


Vlera	21 293 292 (me TVSH)	Monedha Lek
Vlera e nenkontraktimit	_____ me Tvsh	Monedha _____
7. Data e lidhjes së kontratës 26.08.2019
8. Emri dhe adresa e kontraktorit /nenkontraktorit
 Emri INA sh.p.k
 Adresa Tiranë, Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit
 Nr. NIPT J61814009W

Për të kuptuar më mirë materializimin e investimeve të qeverisë në kuadër të Paktit për Universitetin, studentët u pyetën mbi perceptimin e tyre mbi këto investime. Më shumë se gjysma, 57.5% e studentëve, shprehen se këto investime kanë qënë thjesht ndërhyrje vetëm në fasadë, 25.4% mendojnë se investimet nuk kanë sjellë përmirësime infrastrukturore dhe 16.6% e tyre shprehen se investimet në kuadër të Paktit për Universitetin kanë përmirësuar disi kushtet brenda godinave. Qëndrimet e

ndara dhe jo unison të

studentëve, tregojnë se ndërhyrja në godina ka qënë e pjesshme dhe jo sistematike.

Si mendoni se ka ndikuar investimi i qeverisë në kuadër të Paktit për Universitetin në gjendjen e konvikteve



3.2.2 Tërmeti, masat dhe pasojat në RSU Nr.1

Pas tërmetit të 26 Nëntorit 2019 i cili tronditi Shqipërinë, Bashkia Tiranë vendosi të **shëmbë tre(3) godina në Qytetin Studenti**. Inspektoriati I ndërtimit brenda 2 ditëve morri vendim për prishjen vetëm të godinave 15, 18, 19, godina të cilat rezultojnë të ishin të populluara më banorë, të cilët i kishin zaptuar ato që në fillim të viteve 90.

Megjithëse këto godina ishin të vendosura në të njëjtën hapsinë urbane, kryenin të njëjtin funksion dhe ishin ndërtuar në të njëjtën periudhë me godinat e tjera në Q.S, iu nënshtuan të njëjtit intesitet lëkundje, madje sipas dëshmime të gazetarëve investigative dhe të studentëve këto godina pësuan të njëjtat dëmtime me godinat e tjera, por u shembën për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare problemit të shpërnguljes së banorëve informale të cilët i kishin zaptuar ato. Ndërsa për godinat e tjera të dëmtuara të banuara me studentë, përkatësisht godinat 20, 21, 22 apo edhe 23 u vendos për rikonstruksionin e tyre.⁹

Godina të shembura për shkak të tërmetit	Godina të shembura për 15, 18, 19	Të banuara nga qytetarë prej vitit 90'
Godina në restaurim pas tërmetit	20, 21, 22, 23	Të banuara nga studentë

Këshilli Bashkiak Tiranë vendosi t'i mbështesë me bonus qeraje të gjithë familjet që banonin në tri godinat e Qytetit Studenti për një periudhë një vjeçare.

Në datën 6 Dhjetor 2019, një grup prej **30 inxhinierësh vullnetarë nga Kosova** zbarukuan në terren me qëllim inspektimin dhe vlerësimin nga afër të godinave arsimore pas tërmetit, përfshi konviktet, universitetet, shkollat, kopshtet dhe çerdhet (publike dhe jo-publike), si edhe të banesave në Qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Lezhës. Ekipet e inxhinierëve nga Kosova, të shoqëruar nga zyrtarë të njësive administrative, MASR dhe Instituti i Ndërtimit, vlerësuan dëmet pas tërmetit të mbi 200 institucione arsimore.



⁹<https://www.balkanweb.com/godina-18-ne-qytetin-studenti-u-shpall-e-pabanueshme-pas-termetit-nees-24-sjell-pamjet-ekskluzive-ndertesa-nuk-ka-asnje-dem/>

Ndërkohë që ishte duke u realizuar asistencë e ekspertëve nga Kosova për vlerësimin e dëmeve nga tërmeti për objektet arsimore, Bashkia Tiranë shpalli një tender nëpërmjet një procedure me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me rrugë shkresore me përshkrimin **“Konsulencë – Ekspertizë për vlerësimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti, për “Godinat Nr.20-21; Nr.22-23, në RSU. Nr.1”, në vlerën 112.000 euro** me përfitues kompaninë B-VAAL ENGINEERING, veprim dhe shpenzim ky i panevojshëm duke shmangur ekipin e vullnetareve të Kosovës të ardhur për këtë qëllim, por edhe grupet e tjera të ekspertëve vullnetarë vendas dhe të huaj.


Autoritet Prokurues Institucioni Prokurues	Qeverisja Vendore Tiranë Bashkia Tiranë “Konsulencë – Ekspertizë për vlerësimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti, për “Godinat Nr.20-21; Nr.22-23, në RSU. Nr.1. “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me rrugë shkresore”, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 27.11.2019 “Për Shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë” pika 7.1 gërmasa diti përjashtimit, procedurat e prokurimit për mbulimin e nevojave emergjente, si rezultat i dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 (zhvillojnë në rrugë shkresore)
Objekti i Tenderit Nr. Reference Vlera / Fondi Limit	13 750 000,00
Lloji i Kontratës Publike Lloji i Procedurës Statusi i Tenderit	Shërbime Publike Procedurë me Negocim Lidhur Kontrata
Data e Njoftimit të Tenderit Data e fundit për dorëzimin e Dokumenteve Nr. i Operatorëve Konkurrues	
Operatorë Konkurrues Operator Ekonomik Kontraktues Oferta fituese Lekë pa TVSH Data e shpalljes së fituesit Vlera e kontraktuar Lekë me TVSH Data e lidhjes së kontratës Kohëzgjatja e kontratës Shtesë kontrate (Lekë me TVSH)	NET-GROUP SHPK B-VAAL ENGINEERING 15984000 18.12.2019
Ankesa Arsyeja e Anulimit Shënime Transaksionë Thesari	
Buletini i Prokurimeve Publike	Njoftimi i Tenderit Shpallja e Fituesit Lidhur e Kontratës Nr.1 - Dt.13-01-2020

3.2.3 Ndërtimi i Kampusit të Ri Universitar. Me PPP dhe pa konsultim publik.

Në Fletoren Zyrtare të Janarit 2020 u botua vendimi i Këshillit të Ministrave, i cili i delegon Bashkisë Tiranë të drejtën e kontraktimit të kompanive private nëpërmjet formës së Partneritetit Publik – Privat (PPP) për të ndërtuar Kampusin e Ri Universitarë.¹⁰

Sipas të dhënave zyrtare nga Bashkia Tiranë, ky **kampus do të ndërtohet pikërisht nën rrënojat e 3 godinave të rrëzuara pas tërmetit të 26 Nëntorit 2019.**

Ky vendim është marrë përpara se të ndodhte tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe është publikuar në muajin Janar të vitit 2020. Ky mosveprim për të publikuar

Fletoria Zyrtare		Viti 2020 – Numri 7
VENDIM Nr. 908, datë 20.11.2019 PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR PROCEDURËN E PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT, PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE: “NDËRTIMI I KAMPUSIT TË RI TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS”, “NDËRTIMI I GODINËS SË UNIVERSITETIT TË ARTEVE TË TIRANËS” DHE “NDËRTIMI I KORPUSIT TË POLICISË SË SHITËTIT”		
Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13, pika 3, 16 e 18, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ministrit të Kulturës, të ministrit të Bëndërbënës dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave		
VENDOSI:		
1. Përcaktimin e Bashkisë Tiranë si autoritet kontraktor për të ndërtuar dhe për të zhvilluar procedurën për dhënie me koncesion/partneritet publik privat të projekteve: “Ndërtimi i kampusit të ri të Universitetit të Tiranës”, “Ndërtimi i godinës së Universitetit të Arteve të Tiranës” dhe “Ndërtimi i korpusit të Policisë së Shetit”. 2. Komisioni, i cili do ngjitet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet		
4. Ngarkohet Bashkia Tiranë të administrojë procedurën për dhënie me koncesion/PPP, në përputhje me ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, të projekteve, me objekt: “Ndërtimi i kampusit të ri të Universitetit të Tiranës”, “Ndërtimi i godinës së Universitetit të Arteve të Tiranës” dhe “Ndërtimi i korpusit të Policisë së Shetit”. 5. Ministria e Financave dhe Ekonomisë vlerëson e miratton paraprakisht projektet sipas këtij vendimi, si dhe çdo ndryshim apo tamizim të tyre nga planifikimi e implikimeve fiskale, individuale apo të grup për shpenzimet buxhetore, deshiin buxhetor, qëndroshëmërisë e borxhit publik dhe detajimet kontingjente eventuale. 6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Bëndërbënës dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim lyp në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.		
ZEVENDËSKRYEMINISTER Etjon Braçe		
VENDIM Nr. 43, datë 15.1.2020		
PËR FUNKSIONIMIN E PROCESIT TË SHKËMBIMIT TË DOKUMENTEVE NËRMEJ INSTITUCIONEVE, NËPËRMJET SISTEMIT TË QARKËLLIMIT TË DOKUMENTEVE ME NËNSHKRIM ELEKTRONIK		

¹⁰<https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/7/110b8d5c-2993-426d-85dc-45aaa60090c3>

vendimin e qeverisë në Fletoren Zyrtare të muajit Nëntor 2019 dhe nxitimi për të shembur të gjitha godinat e banuara me familjarë pavarësisht se ishin të dëmtuara nga tërmeti, perforcon dyshimet për një dakordësi paraprake të autoriteteve për të vepruar në këtë mënyrë.



Vendimi i qeverisë përjashton nga vendimmarrja dhe konsultimi popullatën kryesore të cilës do t'i shërbejë Kampusi Universitar, siç janë studentët. Në vendim thuhet se Komisioni, i cili do ngrihet nëpërputhje me parashikimet e ligjit nr.125/2013, "Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", të ndryshuar, përndjekjen e

procedurave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet prej nëntë(9) anëtarësh, nga të cilët pesë(5) anëtarë nga Bashkia Tiranë, dy(2) anëtarë nga Agjencia e Trajtit të Koncesioneve (ATRAKO), një(1) anëtar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe 1 (një) anëtar nga Ministria e Brendshme.

Pra përfaqësitë e studentëve dhe të vetë RSU Nr.1, e cila do të menaxhojë kampusin nuk do të marrin pjesë në komisionin e vlerësimit të ofertave, çka nënkupton edhe mungesën e reflektimit të nevojave që kanë realisht studentët.

Në 29 Shkurt 2020 Kryetari i Bashkisë Tiranë publikoi në rrjetin e tij social Facebook një foto të projektit se si do të ndërtohet Kampusi Universitar, duke theksuar se puna për ndërtimin e tij ka nisur. Së pari, projekti i publikuar është foto e një Kampusi Universitar në Boston, SHBA, që do të thotë se ende nuk kemi një projekt serioz të miratuar dhe të studiuar dhe së dyti, **Kryetari i Bashkisë deklaroi publikisht se puna për ndërtimin e kampusit ka nisur ndërkohë** që nuk është publikuar as kontrata konçensionare, shuma e akorduar, përfitim i privatit apo konsultimet me publikun. Gjithashtu nga analiza e të ardhurave dhe nevojave vlen të paragjykohej vendimi i qeverisë dhe Bashkisë Tiranë për të ndërtuar Kampusin Universitar nëpërmjet Partneritetit Publik - Privat në një kohë kur qeveria shqiptare, KFW Gjermane, TIKa Turke dhe 17 sponsor të tjerë kanë ofruar dhjetra miliona euro për rimëkëmbjen e Qytetit Studenti.




3. ZBATIMI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT NGA DREJTORIA E RSU NR.1

Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 gjatë monitorimit dhe testimit të nivelit të transparencës nga Qëndresa Qytetare **rezulton si një nga autoritetet publike më të mbyllur, pa transparence dhe llogaridhënie.**

Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1

- **Nuk disponon një faqe interneti** për të publikuar procedurat dhe kriteret e akomodimit në rezidencë, kontratat, shpenzimet dhe gjithçka që lidhet me llogaridhënien publike.
- **RSU nuk kishte të emëruar një Koordinator për të Drejtën e Informimit.** Koordinatori është emëruar 1 ditë para seancës dëgjimore të 28 Shkurtit 2020, e mbajtur pas ankesës së Qendresës Qytetare pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit.
- Nuk është publikuar **Programi i Transparencës** fizikisht në standë (detyrim sipas ligjit për të Drejtën e Informimit).
- **Faqja zyrtare e RSU NR.1 në Facebook** nga monitorimi i kohështrirjes së saj është përdorur vetëm **si instrument për të shpërndarë** fjalime dhe aktivitete të Bashkisë Tiranë dhe Kryetarit të saj.

KËRKESË PËR INFORMACION		
Kërkuues: Organizata Qëndresa Qytetare	Adresa postare: Rr. "Hoxha Tahiri", Pall. "Vjero", AP.23A/ Tiranë Adresa elektronike: qendresaqytetare@gmail.com www.qendresaqytetare.al	Data: 27/01/2020 Nënshkrimi: 
Autoriteti Publik: Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 (Ish- Trajtimi i Studenteve Nr. 1) Adresa: Rruga Arben Broci, Qyteti Student. Qyteti: Tiranë		

ORGANIZATËS "QËNDRESA QYTETARE"
 RR. "Hoxha Tahiri" Pll Vjero", Ap23A/ Tiranë

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Shoqëria "Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 s.h.a., Tiranë" në zbatim të programit "Adopto një konvik", nëpërmjet bashkëpunimit publik - privat dhe mbështetjes së donatorëve për Bashkinë e Tiranës, ka rikonstruktuar pjesërisht dhe plotësisht disa rezidenca si dhe ka lidhur 17 kontrata sponsorizimi me operatorë të ndryshëm, me qëllimin për përmirësimin e jetesës së studentëve.

Rezidenca Nr. 6 është rikonstruktuar plotësisht me mbështetjen e qeverisë turke nëpërmjet Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim TIK-A-s. Rezidenca Nr. 6 i është nënshtruar rikonstruksionit të plotë duke investuar në të gjithë objektin, ndërhyrje në të gjithë rrjetin hidrosanitar, elektrik etj. Është vendosur sistemi i punëveve diellore dhe sistemi i ngrohjes qëndrore, mobilim i ri në secilin nga dhomat e studentëve. Salla e studimit si dhe çdo dhomë është mobiluar duke krijuar komoditetin e munguar për studentët.

Rezidenca Nr. 11-12 janë në proces rikonstruksionit në kuadër të palatit të Universitetit. Dhomat e studentëve në këto rezidenca do të jenë tërësisht të konceptuara në mënyrë bashkëkohore, mini apartamente me kuzhinë, nyje sanitare dhe sallë studimi me një sipërfaqe të konsiderueshme për të përmbushur kërkesat e studentëve.

Kontratat e qerasë të lidhura midis Shoqërisë dhe të tretëve pas miratimit të Këshillit Mbrojtës për vitin 2019 janë 6, të ardhurat e të cilave shkojnë për mirëmbajtjen e rezidencave dhe territorit të Qytetit Studenti.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ANILA SHEHU



të kërkuar

ra me të tretë gjatë vitit 2019 për
 dinave të Rezidencës Studentore


të ardhurave dhe shpenzimeve
 ana Parking

Qëndresa Qytetare në kuadër të monitorimit tentoi të marrë nga RSU Nr.1 disa informacione bazike që lidhen me menaxhimin financiar si buxheti, kontratat me të tretët dhe prokurimet publike duke përdorur si instrument ligjin për të drejtën e informimit. Pavarësisht se këto informacione duhet

të jenë publike në programin e transparencës së institucionit dhe përgjegjës për këtë është vetë titullari, itinerari i ndjekur nxorri në pah edhe një mangësi që ka në zbatim vetë Ligji për të Drejtën e Informimit.

Pas procedimit me anë të ankesës pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe

Mbrojtjen e të Dhënave Personale (më poshtë KDIMP), Drejtoria e RSU Nr. 1 rezultoi që nuk kishte emëruar Koordinator për të Drejtën e Informimit, të cilin e emëroi pas seancës dëgjimore përballë Qëndresës Qytetare. Edhe pse në prani të Komisionerit dhe kamerave, përfaqësuesja e RSU Nr.1 pohoi se informacioni i kërkuar do t'i vihet në dispozicion Qëndresës Qytetare, përgjigja e datës 5 Mars 2020 nuk pati asnjë nga elementët e kërkuar në kërkesën e datës 27 Janar 2020.



Edhe pas tentativave për të përsëritur ankesën dhe kërkesën, KDIMP në këtë vendimmarrje vërtetoi dobësinë e zbatimit të ligjit dhe urdhërat e vetë institucionit, për të luftuar mungesën e transparencës, llogaridhënies dhe praktikave korruptive që mund të shfaqen në administrimin e Autoriteteve Publike.

Itinerari i Transparencës në RSUNr. 1 me Qendresen Qytetare

DATA	VEPRIMI	PËRMBAJTJA	AUTORIT ETI
27 Janar 2020	Kërkesë për informacion	Kopje e kontratave të lidhura dhe buxheti 2019	RSU Nr. 1
10 Shkurt 2020	Ankesë	Refuzim i informacionit të kërkuar nga RSU Nr.1	KDIMP
28 Shkurt 2020	Seance dëgjimore	Përballje me autoritetin publik (Caktohet Koordinatori për të Drejtën e Informimit në RSU Nr.1)	KDIMP
2 Mars 2020	Vendim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit	Pranimi i ankesës së Qëndresës Qytetare dhe urdhërimi	KDIMP
5 Mars 2020	Kthim përgjigje	Përgjigja nuk përmban informacionin e kërkesës së drejtuar në dt 27 Janar 2020	RSU Nr. 1
9 Mars 2020	Ankesë	Përgjigja e RSU Nr.1 nuk përmban informacionin e kërkuar	KDIMP
10 Mars 2020	Kërkesë e re për informacion	Kopje e buxhetit dhe kontratave	RSU Nr. 1
16 Mars 2020	Ankesë	Refuzim/ informacion i paplotë	KDIMP
19 Mars 2020	Përgjigje	Mbetet në fuqi Urdhri i datës 2 Mars 2020, pavarësisht se është një kërkesë e re	KDIMP

4. KONTRATAT E SPONSORIZIMIT NGA RSU NR.1 PËR VITIN 2019

Gjatë vitit 2019 Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 ka lidhur 20 kontrata më të tretët, ku pjesa më e madhe e tyre janë kontrata sponsorizimi që kanë për objekt ndërhyrjen përmirësuese në godina. Në tabelën më poshtë gjeni kontratat sipas objekteve përkatëse.

Operatori	Objekti i Kontratës	Data
INA sh.p.k	Riparim i pjesshëm i dhomave Godinat 5,20,21,26,27,28,29.	26/08/2019
ED Konstrusion & Alba Konstruksion & Arkondstudio sh.p.k	Rikonstruktim i Godinës 11-12	10.10.2019
Familja Plasa	Furnizimi me 1000 Llamba dhe 190 Pasqyra	04.02.2019
Ferra Construcion sh.p.k	Rikonstruksion i pjesshëm të Godinës Nr.24	18.03.2019
Euro-Beton 2005 sh.p.k	Rikonstruksion i pjesshëm të Godinës Nr.24	18.03.2019
Lugano sh.p.k	Rehabilitimin e fasadës së Godinës Nr.26	07.02.2019
I.D.K Konstruksion sh.p.k	Mobilje të ndryshme në dhomat e studentëve të Godinës Nr.5	13.02.2019
Colosseo Construction sh.p.k	Paisje me hidrosanitare dhe bolierë të Godinës Nr.26	13.02.2019
BAMI sh.p.k	Rikonstruksion i pjesshëm të Godinës Nr.26	03.04.2019
G-2 NDËRTIMI sh.p.k	Rikonstruksion i pjesshëm të Godinës Nr.25	27.03.2019
Arlis Ndërtim sh.p.k	Rikonstruksion i pjesshëm të Godinës Nr.9 dhe Nr.10	25.01.2019
Salillari sh.p.k	Rikonstruksion i pjesshëm të Godinës Nr.27	22.01.2019
Kontak sh.p.k	Rikonstruksion i pjesshëm të Godinës Nr.28 dhe Nr.29	17.01.2019
RUS ENGINEERING sh.p.k	580 dyshekë dhe 500 copë bimësi dekorative të llojeve të ndryshme	10.01.2019
I.D.K Konstruksion sh.p.k	Rikonstruksion i pjesshëm të Godinës Nr.26	2019
ED Konstrusion sh.p.k	Rikonstruksion i pjesshëm të Godinës Nr.5	14.12.2018
Fusha sh.p.k	Rikonstruksion i pjesshëm të Godinave Nr.20 dhe Nr.21	14.12.2018
Gjolena sh.p.k	Mobilimin e dhomave të Godinës Nr.5	10.01.2019
Doppler-Al sh.p.k	Furnizimin dhe vendosjen e të gjitha dyerve të brëndshme në Godinën Nr.5	25.01.2019
Tirana Parking	Parking me qera	07.12.2017

5. REKOMANDIME



- ✓ Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 duhet të zbatohet në mënyrë rigorozë Ligjin për të Drejtën e Informimit. Deri në muajin Shtator 2020 të krijojë web zyrtar, të publikojë Programin e Transparencës, kontaktet e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe buxhetin e 3 viteve të fundit.



- ✓ Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 duhet të parashikojë në buxhetin e vitit të ardhshëm përfshirjen e ofrimit të shërbimit të mensës përkundrejt një çmimi simbolik sipas modelit të Qendrës Studentore Prishtinë.



- ✓ Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 duhet të rishikojë kontratat e akomodimit në aspektin ligjor, në raportin tarifë – shërbim – të drejta duke moslejuar diskriminimin dhe përjashtimin bazuar në mundësitë financiare.



- ✓ Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 duhet të krijojë kushte për organizimin dhe përfaqësimin studentor nëpërmjet zgjedhjeve, për shërbimin e bibliotekave, ambienteve sportive dhe atyre rekreative.



- ✓ Bashkia Tiranë duhet të zbardhë menjëherë projektin real dhe kontratën për ndërtimin e Kampusit të Ri Universitar, të realizojë konsultim me publikun dhe të



përfshijë studentët në Komisionin përzgjedhës të ofertave të privatëve që do e ndërtojnë atë.

- ✓ Këshilli Bashkiak Tiranë të miratojë buxhetin në dispozicion të ofrimit të mensës për studentët në Qytetin Studenti me çmime preferenciale dhe kupona ditore sipas modelit të QS Prishtinë për vitin akademik 2020 – 2021.

- ✓ Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të marrë masat ligjore administrative për titullarin e RSU NR.1 për mos publikimin e Programit të Transparencës dhe të rishikojë praktikën e ndjekura në rastet e kthimit të përgjigjeve pa informacion nga autoritetet publike.

- ✓ Kontrolli i Lartë i Shtetit të auditojë kontratat, objekt i këtij monitorimi në aspektin e performancës dhe rregullshmërisë financiare duke zbardhur mungesën e procedurave ligjore të ndjekura apo praktikën e mundshme korruptive gjatë zbatimit të tyre.

